



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_/\_\_\_/2019

**V E N D I M**

**Nr. 27, Datë 22/02/2019**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 151, datë 19.09.2018, e Z. K.B., ku pretendohet diskriminim për shkak të “bindjes politike<sup>1</sup>”, nga ana e Q.SH.Gj Patos dhe Albpetrol sh.a.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, si dhe mbështetur në dokumentacionin bashkëlidhur saj, rezulton se ankuesi ka punuar pranë Albpetrol sh.a. që prej vitit 1983. Prej vitit 2013 e në vijim, ai ka punuar në pozicionin e rojes së objektit pranë Q.SH.Gj Patos, Fier. Nëpërmjet shkresës nr. 6323, datë 20.07.2018, ankuesi është njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me Albpetrol sh.a., për shkak të pushimit kolektiv. Nëpërmjet ankesës së datës 24.07.2018, ankuesi e ka kontestuar vendimarrjen e Albpetrol sh.a., duke e cilësuar të padrejtë, procesin e vlerësimit dhe pikëzimit të kryer nga komisioni përkatës. Në ankesë, Z. K.B. kërkon të rishikohet vlerësimi i pikëzimit për rastin e tij. Me shkresën nr. 8493, datë 07.09.2018, Albpetrol sh.a. e informon Z. K.B., se procedura e ndjekur në Q.SH.Gj. Patos është konform legjislacionit në fuqi dhe urdhërave që kanë dalë në zbatim të procesit të ristrukturimit të Albpetrol. sh.a. Në shkresën e

---

<sup>1</sup>Referuar kartës së anëtarësisë nr. 123807, datë 20.12.2008, lëshuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë;

<sup>2</sup>Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD;

mësipërme theksohet fakti se mbështetur në strukturën e re organizative të Q.SH.Gj Patos, pozicioni i punës së ankuesit është shkurtuar dhe për këtë shkak, ai është përfshirë në procesin e pikëzimit, bashkë me punonjësit e sektorit përkatës. Referuar procesit të vlerësimit dhe pikëzimit, ankuesi rezultoi me masë disiplinore “vërejtje me shkrim”, dhënë me shkresën nr. 21, datë 02.05.2018, e Albpetrol sh.a., si dhe nuk i plotëson kriteret e mjaftueshme për vazhdimin e marrëdhënieve të punës.

Për sa më sipër, ankuesi pretendon se mbështetur në sistemin e vlerësimit me pikëzim, ai meriton pikët maksimale dhe se Albpetrol sh.a. ka vepruar padrejtësisht ndaj tij, për arsye politike.

### **I. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

**A.** Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 151, datë 19.09.2018, e Z. K.B. u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

**B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7<sup>3</sup>, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Albpetrol sh.a. dhe për dijëni ankuesit, me shkresën nr. 1299/1, datë 26.09.2018, ku kërkohej informacion, lidhur me çështjet e parashtruara nga ankuesi, si dhe iu kërkuua të dërgoheshin aktet e poshtëcituarat:

- Kopje e kontratës individuale të punës së ankuesit me Albpetrol sh.a.;
- Kopje e librezës së punës së ankuesit;
- Masat disiplinore të dhëna për ankuesin gjatë kohës që ka punuar pranë Albpetrol sh.a.;
- Numri i rojeve të objektit pranë Q.SH.Gj Patos me strukturën aktuale dhe me strukturën paraardhëse;
- Kopje e strukturës aktuale dhe të mëparshme të Q.SH.Gj Patos;
- Kopje të procesverbaleve, ku reflektohet procesi i vlerësimit nëpërmjet pikëzimit të rojeve të objektit Q.SH.Gj Patos, si dhe të përcillen kopje të dosjeve personale të të gjithë rojeve, që i janë nënshtruar këtij procesi.

---

<sup>3</sup> Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon : “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

1. Në përgjigje të shkresës nr. 1299/1, datë 26.09.2018, së Komisionerit, Administratori i Albpetrol sh.a. dërgoi shkresën nr. 9318/1, datë 09.10.2018<sup>4</sup>, nëpërmjet së cilës e informon Komisionerin se Z. K.B. është punonjës i Albpetrol sh.a., në pozicionin e punës “roje objekti”, pranë Qendrës së Shërbimit Gjeofizik Patos. Gjatë marrëdhënieve të punës me Shoqërinë “Albpetrol” sh.a. ai ka punuar në disa pozicione pune, si vijon: (1) Termist pranë Uzinës Mekanike Patos, nga data 18.04.1983, deri në datën 01.11.2011; (2) Punëtor pranë Qendrës së Shërbimeve Hidrokarbure Patos, nga data 01.11.2011, deri në datën 01.05.2013; (3) Roje objekti pranë Qendrës së Shërbimit Gjeofizik Patos, nga data 01.05.2013 e në vazhdim.

Në zbatim të Programit të Zhvillimit të Rishikuar për vitin 2018, miratuar me Vendimin nr. 8, datë 07.06.2018, të Këshillit Mbikqyrës të “Albpetrol” sh.a. dhe Vendimit nr. 496/10, datë 25.06.2018, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Shoqëria “Albpetrol” sh.a. është në proces ristrukturimi për reduktimin e fuqisë punëtore. Për këtë arsye ka ndërmarrë hapat për nisjen e procedurave të pushimit kolektiv duke njoftuar punonjësit që preken nga ky proces. Në kuadër të këtij procesi është nënshkruar Akt-Marrëveshja me Organizatën Sindikale, e cila është në cilësinë e përfaqësueses së punëmarrësve, për përcaktimin e kriterëve, mbi të cilat do të kryhet procedura e pushimit kolektiv.

Albpetrol sh.a. shprehet se procedura e ndjekur nga Qendra e Shërbimeve Gjeofizike Patos është konform legjislacionit në fuqi dhe urdhërave që kanë dalë në zbatim të procesit të ristrukturimit të shoqërisë. Pozicioni i punës së Z. K.B. është shkurtuar dhe për këtë arsye ai i është nënshtruar procesit të vlerësimit dhe pikëzimit bashkë me punonjësit e tjerë të sektorit përkatës. Mbështetur në strukturën e re organizative të Qendrës së Shërbimeve Gjeofizike Patos janë reduktuar 4 pozicione pune “roje objekti”, nga 12 pozicione të tilla, pune, të cilat kanë qënë në strukturën e mëparëshme organizative.

Punonjësit e Qendrës së Shërbimit Gjeofizik, Patos i janë nënshtruar një procesi vlerësimi dhe pikëzimi të kryer nga komisioni përkatës, i ngritur në zbatim të Urdhërit nr. 50, datë 02.07.2018, të Administratorit të Shoqërisë. Shoqëria “Albpetrol” sh.a., për të kryer një proces sa më transparent, ka aplikuar një sistem përzgjedhjeje me anë të vlerësimit me pikë, mbi bazën e të cilit janë përzgjedhur se do të qendrojnë në punë ata punonjës, të cilët janë vlerësuar me më shumë pikë. Kriteret, mbi bazën e të cilave u krye vlerësimi ishin arsimiti, kualifikimi dhe vjetërsia në punë. Për të gjitha këto procedura është arritur një Marrëveshje e Përbashkët midis Shoqërisë “Albpetrol” sh.a. në cilësinë e punëdhënësit dhe Sindikatës së Re të Naftëtarëve, në cilësinë e subjektit, i cili mbron interesat e punëmarrësve. Kjo sindikatë ka nënshkruar edhe kontratën kolektive në fuqi me Shoqërinë “Albpetrol” sh.a.

---

<sup>4</sup>Shkresa i është dërguar për dijeni edhe ankuesit.

Ndërprerja e marrëdhënieve të punës me punonjësën K.B., nuk vlerësohet si pushim individual, por si pushim kolektiv për shkak të numrit të punonjësve, të cilët janë përfshirë në këtë proces, në referencë të nenit 148, pika 1, të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë. Albpetrol sh.a sqaron se marrëdhënia punëdhënës-punëmarrës, pra raporti midis shoqërisë Albpetrol sh.a dhe Z. K.B. nuk është aspak individual dhe i lidhur me pretendimin e tij, se është njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të bindjeve politike. Përzgjedhja e punonjësve, të cilët do të vazhdojnë marrëdhëniet e punës dhe të atyre që do t'ju ndërpriten marrëdhëniet e punës nuk ka patur asnjë kriter diskriminues, por ashtu si u bë e qartë dhe më sipër është kryer mbi bazën e pikëzimit nga një Komision i Posaçëm. Në shkresën e Albpetrol sh.a. theksohet fakti se në asnjë praktikë, apo shkresë të punëdhënësit “Albpetrol” sh.a. nuk është përmendur përkatësia politike e ndonjë prej punonjësve.

Albpetrol sh.a. ka dërguar bashkëlidhur shkresës së sipërpërmendur dokumentacionin e kërkuar nga Komisioneri<sup>5</sup>.

C. Në vijim të ndjekjes së procedurave hetimore mbi ankesën nr. 151, datë 19.09.2018, e Z. K.B., Komisioneri vendosi të realizojë një seancë dëgjimore në datën 23.11.2018.

Në seancë dëgjimore u paraqit ankuesi dhe përfaqësuesi i Albpetrol sh.a., Z. A. V. Ky i fundit depozitoi Autorizimin nr. 11612 Prot., datë 22.11.2018, e Administratorit të Albpetrol sh.a., nëpërmjet së cilit autorizohej për përfaqësim të kësaj shoqërie në këtë seancë dëgjimore pranë KMD-së.

Ankuesi K.B. parashtroi edhe një herë pretendimet e tij për diskriminim për shkak të bindjes politike, si pasojë e largimit të tij nga puna nëpërmjet pushimit kolektiv. Ankuesi pretendoi se ai ka një përvojë shuëvjeçare pune, rreth 38 vjet pune, pranë kësaj shoqërie dhe nuk duhej të përfshihej në pushimin kolektiv të zbatuar nga Albpetrol sh.a. Z. K.B. theksoi faktin se ka përfunduar arsimin e mesëm (2 shkolla të mesme), si dhe është punonjës i kategorisë së 7. Ankuesi pretendoi se punonjës të tjerë që kanë punuar në pozicionin e rojes dhe kanë patur vjetërsi me të vogël në punë, nuk i janë nënshtruar pushimit kolektiv. Ai pretendoi gjithashtu se disa prej punonjësve që kanë punuar në pozicionin e rojes dhe janë mbajtur në punë janë anëtarë të Partisë Socialiste, të tillë si Z. SH.B. dhe R.G. Njëkohësisht, ai u shpreh se e njëjta masë disiplinore që është marrë ndaj tij, është dhënë edhe për roje të tjerë, të cilët punojnë ende pranë Q.SH.M.N.Gj. Patos. Vërejtja e dhënë ndaj tij ka motivacion “dëmtimin e pronës”.

---

<sup>5</sup>Në këtë dokumentacion mungojnë disa nga procesverbalet e vlerësimit me pikëzim, të punonjësve, që i janë nënshtruar këtij vlerësimi, të cilët kanë punuar dhe vazhdojnë ende të punojnë në pozicionin e punës “roje objekti” pranë Qendrës së Shërbimit Gjeofizik, Patos.

Z. K.B. u shpreh se ka qenë subjekt i kontrolleve të herëpashërëshme nga ana e përgjegjës të Sektorit të Burimeve Njerëzore, të qendres. I pyetur në lidhje me aktivitetin e tij politik, ai u shpreh se nuk ka aktivitet politik, por është anëtar i PD-së. Ankuesi u shpreh se dikur ka qenë Komisioner për këtë forcë politike, por nuk kujtonte vitet në të cilat kishte qenë komisioner.

Përfaqësuesi i Albpetrol sh.a. bëri një përshkrim të procesit të ristrukturimit të Albpetrol sh.a., duke theksuar faktin se ky ristrukturim ka sjellë si pasojë përfshirjen në pushim kolektiv të 479 punonjësve, nga 550 të tillë që janë parashikuar për t'iu bashkuar këtij pushimi. Ai u shpreh se pushimi kolektiv ka përfshirë shumë punonjës si në administratën qendrore të shoqërisë, ashtu edhe në 11 qendrat e saj të prodhimit dhe shërbimit, por largimet nga puna në kuader të ristrukturimit në asnjë rast nuk kanë patur karakter politik. Përfaqësuesi i Albpetrol sh.a. sqaroi se 29 punonjës i janë nënshtruar pushimit kolektiv pranë Q.SH.M.N.Gj-së Patos. Ai sqaroi se Z. K.B. është larguar nga puna si pasojë e përfshirjes në këtë pushim kolektiv dhe largimi i tij nuk është individual. Nga 12 punonjës në pozicionin e rojes pranë kësaj qendre, 4 prej tyre i janë nënshtruar pushimit kolektiv. Këta punonjës janë seleksionuar pas vlerësimit me pikëzim, të kryer nga Komisioni i Vlerësimit pranë Q.SH.M.N.Gj. Patos. Z. K.B. ka depozituar ankesë pas njoftimit për pushim kolektiv të kryer nga Albpetrol sh.a. dhe Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave i ka dërguar përgjigje zyrtare, ku e sqaron, lidhur me ankesën e tij. Përfaqësuesi i Albpetrol sh.a. theksoi faktin, se Z. K.B. ka patur takim edhe me Administratorin e Shoqërisë, ku është sqaruar mbi përfshirjen e tij në pushimin kolektiv. Z. A.V. u shpreh se punonjësit e përfshirë në pushim kolektiv do të kenë përparësi për t'u ripunësuar pranë Albpetrol sh.a., në momentin që do të krijohen vende të lira pune, si pasojë e daljes në pension të punonjësve që kanë mbushur moshën apo punonjësve të larguar me masa disiplinore. Përfaqësuesit e KMD-së kërkuan nga përfaqësuesi i Albpetrol sh.a. që të dërgonte në vijim të seancës dëgjimore, procesverbalet e vlerësimit me pikëzim, për të 12 punonjësit që kanë punuar në pozicionin e rojes, si dhe të parashtronte me shkrim kundërshtimet e tij lidhur me pretendimet e ankusit në këtë seancë dëgjimore.

1. Në vijim të seancës dëgjimore, ankuesi K.B. depozitoi shkresën nr. 1678, datë 03.12.2018, ku parashtronte disa sqarime të mëtejshme, lidhur me disa çështje të trajtuara në seancë dëgjimore. Shkresa e sipërpërmendur u dërgua me e-mail në adresë të Albpetrol sh.a., në datën 04.12.2018, ku kësaj shoqërie iu kërkua të parashtronte informacionin vijues pas seancës dëgjimore.
2. Albpetrol sh.a. dërgoi me e-mail, në datën 04.02.2019, procesverbalet e vlerësimit me pikëzim për të 11 punonjësit që kanë punuar në pozicionin e rojes pranë QSHGJ Patos.

## **II. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuesit nga Albpétrol sh.a., si pasojë e përfshirjes në pushimin kolektiv të zbatuar nga kjo shoqëri në kuadër të ristrukturimit të saj.**

Z. K.B. ka punuar pranë Albpétrol sh.a. prej vitit 1983. Gjatë marrëdhënieve të punës me Shoqërinë “Albpétrol” sh.a. ai ka punuar në disa pozicione pune. Përgjatë periudhës kohore, që i përket datave 18.04.1983 - 01.11.2011, ankuesi ka punuar në pozicionin “termist” pranë Uzinës Mekanike Patos. Në vijim, nga data 01.11.2011, deri në datën 01.05.2013, ka punuar në pozicionin “Punëtor” pranë Qendrës së Shërbimeve Hidrokarbure Patos. Më pas, duke filluar nga data 01.05.2013 ka punuar “Roje objekti” pranë Qendrës së Shërbimit Gjeofizik Patos deri në momentin, kur u përfshi në pushimin kolektiv të zbatuar nga shoqëria Albpétrol sh.a. Marrëdhëniet e punës ndërmjet ankuesit K.B. dhe Shoqërisë Albpétrol sh.a. janë rregulluar nëpërmjet kontratave individuale të punës, së lidhur ndërmjet palëve. Kontrata e fundit e punës, e lidhur ndërmjet tyre, ka qenë Kontrata Individuale e Punës nr. 634/129, datë 22.07.2014.

Referuar kartës së anëtarësisë nr. 123807, datë 20.12.2008, lëshuar nga forca politike Partia Demokratike e Shqipërisë, ankuesi rezulton të jetë anëtar i kësaj force politike.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit administrativ të ankesës nr. 151, datë 19.09.2018, rezulton se mbështetur në Programin e Zhvillimit të Rishikuar për vitin 2018, të miratuar me Vendimin nr. 8, datë 07.06.2018, të Këshillit Mbikqyrës dhe Vendimin nr.496/10, datë 25.06.2018, e Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë, Shoqëria Albpétrol sh.a. është duke zbatuar një proces ristrukturimi, si rrjedhim i së cilit i janë nënshtruar pushimit kolektiv rreth 450 punonjës, që bëjnë pjesë në administratën e kësaj shoqërie dhe në qendrat e prodhimit e shërbimit në varësi të saj. Nga përmbajtja e akteve të sipërpërmendura rezulton se ky është një proces madhor që po ndodh në këtë shoqëri, si pasojë e ndryshimeve të treguesve kryesore të Programit të Zhvillimit Ekonomik të Shoqërisë “Albpétrol” sh.a. për vitin 2018. Në nenin 147, pika 1, të Kodit të Punës parashikohet: *“1. Vlerësohet pushim kolektiv nga puna përfundimi i marrëdhënieve të punës nga punëdhënësi, për arsye që nuk kanë të bëjnë me punëmarrësin, kur numri i pushimeve nga puna, brenda 90 ditëve, është, të paktën, 10 punëmarrës për ndërmarrjet me deri në 100 punonjës; 15, për ndërmarrjet me mbi 100 deri në 200 punonjës; dhe 20, për ndërmarrjet me mbi 200 punonjës”*. Numri i punonjësve që i janë

nënshtuar pushimit kolektiv pranë Albpetrol sh.a ka qenë rreth 450 të tillë, duke u konsideruar një pushim kolektiv me përmasa të konsiderueshme.

Në pikën 2, të Vendimit nr.496/10, datë 25.06.2018, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë “Mbi miratimin e ndryshimit të programit të zhvillimit të shoqërisë “Albpetrol” sh.a. për vitin 2018” parashikohet shprehimisht: “Miratimin e procesit të ristrukturimit organizativ të njëjësive të Shoqërisë, reduktimit të fuqisë punëtore, strukturës organizative dhe miratimin e numrit total të punonjësve, sipas Vendimit të Këshillit Mbikqyrës nr. 8, datë 07.06.2018, pikat 2,3,4,5,6.”

Në pikën 2, të Vendimit nr. 8, datë 07.06.2018, të Këshillit Mbikqyrës të Albpetrol sh.a miratohet procesi i ristrukturimit organizativ të shoqërisë dhe reduktimit të fuqisë punëtore, si dhe parashikohet përfundimi i këtij procesi brenda datës 01.10.2018. Në pikën 3 të vendimit në fjalë miratohet Struktura Organizative e Shoqërisë “Albpetrol” sh.a.me përbërje 3 (tre) Qendra të Prodhimit të Naftës, 7 (shtatë) Qendra Shërbimi dhe Administrata Qendrore. Në këtë vendim miratohet gjithashtu edhe numri total i punonjësve të Shoqërisë prej 1,828 punonjës, pas përfundimit të procesit të ristrukturimit organizativ, të shpërndarë sipas qendrave.

Në kushtet kur, fuqia punëtore e kësaj shoqërie do të reduktohej me rreth 450 punonjës, si dhe duke patur parasysh faktin se ndërmjet Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptarë (SRNSH) dhe Albpetrol sh.a. është lidhur një kontratë kolektive për punonjësit e kësaj shoqërie, në referencë të nenit 148, pika 3, të Kodit të Punës, Albpetrol sh.a. bëri këshillime me organizatën sindikale, e njohur si përfaqësuese e punëmarrësve, me qëllim që të arrihet një marrëveshje. Në këtë kontekst u realizuan takime me sindikatën e sipërpërmendur në mënyrë që të përcaktoheshin kriteret për kryerjen e reduktimit të fuqisë punëtore dhe rregullat e përgjithshme, të cilave do t’u nënshtoheshin punonjësit e kësaj shoqërie.

Në bazë të Akt-Marrëveshjes së lidhur ndërmjet Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptarë (SRNSH) dhe Albpetrol sh.a., kriteret, të cilat do të merreshin në konsideratë gjatë procesit të ristrukturimit të shoqërisë dhe reduktimit të fuqisë punëtore ishin: (1) Arsimi, (2) Kualifikimi profesional/kategoria/patentë specifike dhe (3) vjetërsia në punë në industrinë e naftës.

Përzgjedhja e punonjësve sipas kriterëve të përcaktuara më sipër do të kryhej sipas vlerësimit me pikë të përcaktuar në këtë marrëveshje. Sipas shpjegimeve të dhëna nga strukturat e Albpetrol sh.a., vlerësimit nëpërmjet sistemit të pikëzimit do t’i nënshtroheshin vetëm ata punonjës, të cilët kishin pozicione të njëjta punë, ndërkohë që nga këto pozicione, disa prej tyre suprimoheshin. Punonjësit që kishin pozicion pune unik ose të vetëm dhe ky pozicion shkurtohej, nuk i nënshtroheshin vlerësimit nëpërmjet sistemit të pikëzimit.

Në vijim, Albpetrol sh.a. miratoi aktet nënligjore, nëpërmjet së cilave përcaktoi rregullat e hollësishme, lidhur me mënyrën se si do të kryhej ristrukturimi dhe reduktimi i fuqisë punëtore. Aktet përkatëse konsistojnë në Urdhërin nr. 49, datë 02.07.2018, e Administratorit për fillimin e procesit të ristrukturimit organizativ dhe reduktimin e fuqisë punëtore të Albpetrol sh.a.; Urdhërin nr. 50, datë 02.07.2018, e Administratorit për ngritjen e Komisioneve dhe kryerjen e procesit të ristrukturimit, si dhe Shtojcën nr.1 e cila është pjesë integrale e këtij urdhëri; Urdhërin nr.51, datë 02.07.2018, të Administratorit për përcaktimin e përfaqësuesve të administratës që do të jenë pjesë e komisioneve në Qendrat e Prodhimit dhe Shërbimit, si dhe Urdhërin nr. 63, datë 16.07.2018, të Administratorit të Albpetrol sh.a., lidhur me procedurën e kontrollit dhe Administrimit të procesit të ankimeve të punonjësve që preken nga ristrukturimi dhe reduktimi i fuqisë punëtore të Albpetrol sh.a.

Në referencë të Akt-Marrëveshjes me Sindikatën e Naftëtarëve, Albpetrol sh.a. iu drejtua të gjithë qendrave në varësi të tij, me shkresën nr. 5537, datë 02.07.2018, nëpërmjet së cilës i njoftonte në lidhje me përfaqësuesit e Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptarë, që do të ishin pjesë e Komisioneve të Vlerësimit të ngritura në çdo qendër.

Në referencë të Vendimit nr.14, datë 29.08.2018, të Këshillit Mbikqyrës së Albpetrol sh.a., “*Mbi programin e zhvillimit ekonomik të rishikuar për vitin 2018*”, numri i përgjithshëm i punonjësve të Q.A.K.P., Patos, pas kryerjes së ristrukturimit të shoqërisë është reduktuar<sup>6</sup>, në krahasim me numrin e mëparshëm të punonjësve<sup>7</sup> pranë kësaj qendre. Në zbatim të nenit 147, pika 5, të Kodit të Punës, 32 vende pune janë suprimuar pranë kësaj qendre. Punonjësit respektivë të Q.SH.Gj., Patos janë njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënive të punës, si pasojë e pushimit kolektiv. Z. K.B. punonte në pozicionin e punës “*roje objekti*”, pranë kësaj Qendre. Numri i pozicioneve të punës “*roje objekti*” në Qendrën e Shërbimeve dhe Gjeofizikës Patos përpara ristrukturimit të Shoqërisë “Albpetrol” sh.a. ishte **12 vende pune**, ndërkohë që, pas procesit të ristrukturimit organizativ, numri rojeve është reduktuar në **8 vende pune**. Për sa më sipër, rezulton se **4 pozicione pune “roje”**, janë suprimuar<sup>8</sup>. Në kushtet kur, nga 12 punonjës, që punonin në pozicionin “*roje objekti*” pranë Q.Sh.Gj. Patos, 4 prej tyre do të shkurtoheshin, Komisioni i Vlerësimit, i ngritur pranë kësaj qendre, në bazë të Urdhërit nr. 50, datë 02.07.2018, të Administratorit të Albpetrol sh.a., kreu vlerësimin e tyre me pikëzim, sipas kriterëve të miratuara në Akt-marrëveshjen me Sindikatën e Naftëtarëve, ndryshuar me Shtojcën nr. 1, pjesë integrale e këtij Urdhëri. Kriteret, që u morën në konsideratë gjatë procesit të ristrukturimit të shoqërisë dhe

<sup>6</sup> Referuar Strukturës Organizative të Qendrës së Shërbimeve Gjeofizike Patos, të miratuar nga Administratori K.B. numri i përgjithshëm i punonjësve është 95 punonjës, përkatësisht 27 nëpunës dhe 68 punëtorë;

<sup>7</sup> Referuar Strukturës Organizative të Qendrës së Shërbimeve dhe Gjeofizikës Patos, të miratuar nga Administratori i Albpetrol sh.a. E.P., numri i përgjithshëm i punonjësve është 127 të tillë, përkatësisht 33 nëpunës dhe 94 punëtorë.

<sup>8</sup> Sipas informacionit të administruar nga Albpetrol sh.a rezulton se njëri prej pozicioneve “*roje*” që suprimuan ishte vakant, pasi punonjësi kishte dalë në pension pleqërie.



reduktimit të fuqisë punëtore ishin: (1) Arsimi, (2) Kualifikimi profesional/kategoria/patentë specifike dhe (3) vjetërsia në punë në industrinë e naftës. Referuar procesverbalit të vlerësimit me pikëzim të Z. K.B. rezulton se ai është vlerësuar me 75 pikë, nga të cilat 35 pikë i përfiton nga arsimi i tij, 20 pikë i përfiton falë eksperiencës së tij në punë, pasi ka punuar 36 vite në industrinë e naftës dhe është vlerësuar me 20 pikë, për kualifikimin e tij, në bazë të kriterit të kualifikimit profesional, për pozicionin e sipërpërmendur të punës.

Referuar Dispozitës së Fundit të Shtojcës 1, të Urdhërit nr. 50, datë 02.07.2018, të Administratorit të Albpetrol sh.a. përcaktohet: *“Në kryerjen e procesit të vlerësimit dhe pikëzimit, Komisioni për të përzgjedhur punonjësit që preken nga procesi i ristrukturimit organizativ dhe të fuqisë punëtore, pavarësisht klasifikimit të mësipërm, do të marrë në konsideratë edhe treguesit e mëposhtëm të performancës në punë:*

- *Masat disiplinore që rezultojnë për atë punonjës;*
- *Vlerësimi i treguesve në punë.”*

Referuar procesverbalit të vlerësimit me pikëzim, konstatohet se performanca e tij në punë cilësohet e dobët, pasi ankuesi rezulton me masë disiplinore. Në dokumentacionin e depozituar nga Albpetrol sh.a. rezulton se nëpërmjet shkresës nr. 89, datë 04.04.2016, së Albpetrol sh.a., ankuesit i është dhënë masa disiplinore *“vërejtje me shkrim”*, e cila në momentin e pushimit kolektiv ka qenë e parashkruar. Njëkohësisht, nëpërmjet shkresës nr. 4500, datë 28.05.2018, të Albpetrol sh.a. ankuesit i është dhënë një tjetër masë disiplinore *“vërejtje me shkrim”*, pas një ngjarjeje të ndodhur pranë Q.SH.Gj. Patos, në datën 03.04.2018, ku u konstatua humbje e bazës materiale të kësaj qendre. Z. K.B. fajësohet për neglizhencë dhe shkelje të rregullave të shërbimit. Në momentin e kryerjes së vlerësimit me pikëzim nga ana e Komisionit të Vlerësimit pranë Q.SH.GJ. Patos, kjo masë ka qenë në fuqi.

Referuar akteve të depozituara nga ana e Albpetrol sh.a. rezulton se edhe punonjës të tjerë që kanë punuar në pozicionin *“roje”* pranë Q.SH.Gj. Patos, të cilët kanë patur masa disiplinore në fuqi, i janë nënshtruar pushimit kolektiv, të tillë si punonjësi A.T., i cili është ndërshkruar me masë disiplinore, për të njëjtën ngjarje, sikurse ankuesi.

Albpetrol sh.a. depozitoi procesverbalet me pikëzim për 11 punonjës në pozicionin e rojes, nga 12 të tillë, që është kërkuar zyrtarisht nga KMD. Kjo pasi, në njërin prej pozicioneve të suprimuara ka punuar një punonjës, i cili në momentin e zbatimit të pushimit kolektiv kishte dalë në pension pleqërie. Referuar procesverbaleve të vlerësimit rezulton se ka patur punonjës, të cilët edhe pse janë vlerësuar me më pak pikë ose me pikë të njëjta me ankuesin, janë kualifikuar, pasi rezulton se nuk kanë patur masa disiplinore dhe performanca e tyre në punë është cilësuar e mirë. Referuar procesverbalit nr. 376/4, datë 04.07.2018, rezulton se punonjësit A. M., vlerësuar me 55

pikë, SH. B., vlerësuar me 75 pikë, R. G., vlerësuar me 45 pikë dhe G. H., vlerësuar me 45, rezultojnë të jenë kualifikuar. Në këtë procesverbal citohet: *“Në përfundim, komisioni vendosi që punonjësit e sipërpërmendur nuk ju nënshtruan procesit të ristrukturimit si pasojë e performancës së mirë të tyre në punë, efikasitet, dhe vlerësimin pozitiv nga komisioni për këto punonjës”*. Përveç sa më sipër, rezulton se ka edhe punonjës të tjerë që janë vlerësuar me më tepër pikë sesa ankuesi dhe nuk kanë patur masa disiplinore, të tillë si Z. S. RR., i cili referuar Procesverbalit të Vlerësimit nr. 376/4 Prot, datë 04.07.2018, është vlerësuar me 80 pikë dhe nuk ka patur asnjë masë disiplinore. Në këto kushte, Z. S. RR. nuk i është nënshtruar pushimit kolektiv.

Për sa më sipër, rezulton se masa disiplinore e dhënë ndaj ankuesit ka qenë arsyeja, që ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në përfshirjen e tij në pushimin kolektiv të zbatuar nga Albpetrol sh.a.

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit me pikëzim, Albpetrol sh.a. e ka njoftuar Z. K.B., me anë të shkresës nr. 6323, datë 20.07.2018, lidhur me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të pushimit kolektiv. Në vijim, nëpërmjet ankesës së datës 24.07.2018, ankuesi e ka kontestuar vendimarrjen e Albpetrol sh.a., duke e cilësuar të padrejtë, procesin e vlerësimit dhe pikëzimit të kryer nga komisioni përkatës. Në ankesë, Z. K.B. kërkon të rishikohet vlerësimi i pikëzimit për rastin e tij. Me shkresën nr. 8493, datë 07.09.2018, Albpetrol sh.a. e informon Z. K.B., se procedura e ndjekur në Q.SH.Gj. Patos është konform legjislacionit në fuqi dhe urdhërave që kanë dalë në zbatim të procesit të ristrukturimit të Albpetrol. sh.a., si dhe referuar procesit të vlerësimit dhe pikëzimit, ankuesi rezulton me masë disiplinore “vërejtje me shkrim”.

Në referencë të shkresës nr. 5537, datë 02.07.2018, së Albpetrol sh.a., rezulton se në çdo Komision Vlerësimi të ngritur pranë çdo qendre prodhimi apo shërbimi, në varësi të Albpetrol sh.a., bën pjesë në cilësinë e anëtarit edhe një përfaqësues i Sindikatës së Naftëtarëve, e cila është përfaqësuese e punonjësve të Albpetrol sh.a. Kjo shërben si një garanci për të gjitha veprimet e kryera nga Komisionet përkatëse, pasi përfaqësuesit e Sindikatës mbrojnë interesat e punonjësve të Albpetrol sh.a.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se Albpetrol sh.a. nuk ka ndërmarrë veprime që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj ankuesit, ose që e kanë ekspozuar atë, ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, në krahasim me persona të tjerë, që ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme me të.

Në mungesë të trajtimit të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë, Komisioneri gjykon se nuk kemi të bëjmë me diskriminim për shkakun e pretenduar nga ankuesi.

## **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 9, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të “bindjes politike”, të Z. K.B., nga ana e Albpetrol sh.a.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Robert GAJDA**

---

**KOMISIONERI**

Fusha – punësim  
Shkak – bindja politike